

Çfarë duhet të dijnë prindërit dhe kujdestarët rreth platformës

RUMBLE

Një platformë e krijuar për ndarjen e videove si një alternativë ndaj YouTube, Rumble është mishërimi i një 'djegësi të ngadaltë' në qarqet dixhitale: fillimisht u lansua në vitin 2013, por vetëm në dy ose tre vitet e fundit ka filluar të fitojë tërheqje serioze. Pjesa më e madhe e rritjes së fundit të Rumble ka ardhur nga lidhja e saj me Truth Social, platforma e themeluar nga ish-presidenti i SHBA-së, Donald Trump. Përmbajtja e Rumble shpesh pasqyron disa këndvështrime intensive politike; kjo shpesh mund të ndikojë në mënyrën se si i qaset temave dhe herë pas here ka bërë që platforma të futet në një territor të diskutueshëm.

Cilat janë rreziqet?

AGE RESTRICTION
12+

on the App Store;
"Teen" on Google Play

PËRKATËSITË POLITIKE

Kompania që ka krijuar lojën Rumble është gjithashtu përgjegjëse për udhëheqjen e rrjetit social Truth Social, që shpesh përmban lajme të diskutueshme dhe është rrjet social i themeluar nga Donald Trump. Në të vërtetë, përmbajtja e Rumble shpesh pasqyron idetë e një grupi votuesish amerikanë, të cilët e kanë përqaftuar atë si një alternativë ndaj mediave sociale të zakonshme. Shumë prindër mund të mendojnë se një platformë e tillë e hapur politike nuk është e përshtatshme për të rinjtë.

PËRMBAJTJE PROVOKATIVE

Rumble krenohet me mbrojtjen e fjalës së lirë, me CEO-n e saj që e deklaroi platformën "imune ndaj kulturës cenzoruese (Cancel Culture)". Shumë nga krijuesit e përmbajtjes së profilit më të lartë të Rumble si Andrew Tate dhe Russell Brand - janë të njohur për ndarjen e opinionëve të cilat shpesh përshkruhen si ekstreme. Ndërsa të rriturit mund të jenë të pajisur për ta trajtuar këtë përmbajtje në mënyrë objektive, pjesa më e madhe e saj mund të mos jetë e përshtatshme për një audiencë të re.

MATERIAL I PAPËRSHTATSHËM

Me fjalë shumë të thjeshta, Rumble funksionon gati si YouTube, por shumë më pak cenzurë dhe kufizime që aplikohen në përmbajtjen e saj si platformë. Nëse materialet e papërshtatshme për moshën ose dezinformatat potencialisht të dëmshme janë në tendencë në platformë dhe po shpërndahen mes përdoruesve më të pjekur, ekziston një mundësi e veçantë që algoritmi i Rumble t'ia rekomandojë atë përmbajtje edhe një fëmije.

FIGURAT KONTRAVERSE

Shumë nga llogaritë më të njohura të Rumble janë në pronësi të individëve që më parë janë ndaluar nga platformat e tjera të mediave sociale. Sigurisht, mund të ketë një sërë arsyesh prapa kësaj - por kjo me siguri rrit shanset që fëmija juaj të hasë në përmbajtje në Rumble, të cilat ndoshta nuk do të konsideroheshin të pranueshme në platforma të tjera të ngjashme.

TEMA TE NDJESHME

Në muajt e fundit, disa ndikues të shquar të Rumble kanë shprehur pikëpamje të pakompromis për tema të ndjeshme si kontrolli i armëve, aborti, çështjet rreth LGBTQ dhe më shumë. Në shumë llogari, Rumble ka prirje për të shfaqur një paragjykim të dukshëm politik, shqetësimi do të ishte se të rinjtë që përdorin platformën mund të mos jenë gjithmonë të tillë, duke u paraqitur me një këndvështrim të paanshëm për këto tema të rëndësishme dhe komplekse.

KËSHILLË PËR PRINDËRIT & KUJDESTARËT

FLISNI RRETH POLITIKËS

Rumble posedon një ekip moderatorësh, por natyra e platformës do të thotë që disa përmbajtje të lejuara ka të ngjarë të jenë të diskutabile dhe shumë subjektive. Kjo mundësi mund t'i bëjë shumë prindër të mos ndihen rehat - por nëse fëmija juaj shikon (ose dëgjon për) diçka provokuese në Rumble, mund të ofrojë gjithsesi një mundësi të dobishme për të diskutuar politikën në shtëpi në një mjedis të sigurt dhe të relaksuar.

KONTROLLONI RREGULLISHT

Ashtu si çdo platformë për ndarjen e videove, ekziston mundësia që Rumble të sugjerojë përmbajtje të papërshtatshme për fëmijën tuaj. Mund të ketë një problem algoritmi - ose mund të jetë që rekomandimet bazohen në videot që ata kanë shikuar më parë. Nëse fëmija juaj përdor Rumble, mund të merrni parasysh një bisedë me të rreth llogarive që ndjek dhe çfarë lloj përmbajtjeje është e përshtatshme për moshën e tyre.

ALTERNATIVA KËRKIMORE

Natyrisht, asnjë platformë për ndarjen e videove nuk është plotësisht e lirë nga përmbajtjet potencialisht të dëmshme, por numri i poseduesve të shquar të llogarive në Rumble, prodhimi i të cilëve më parë është ndaluar nga shërbime të ngjashme është sigurisht një shkak për shqetësim. Nëse fëmija juaj po interesohet në mënyrë specifike për kulturën ose politikën e influencerëve, ndoshta mund të hulumtoni së bashku më shumë platforma miqësore për familjen.

DISKUTIMI I PAANSHMERISË

Natyrisht, asnjë platformë për ndarjen e videove nuk është plotësisht e lirë nga përmbajtjet potencialisht të dëmshme, por numri i poseduesve të shquar të llogarive në Rumble, prodhimi i të cilëve më parë është ndaluar nga shërbime të ngjashme është sigurisht një shkak për shqetësim. Nëse fëmija juaj po interesohet në mënyrë specifike për kulturën ose politikën e influencerëve, ndoshta mund të hulumtoni së bashku më shumë platforma miqësore për familjen.

PENKOS

Parents Education Network of Kosova

Përkthim dhe përshtatje

Source: <https://www.pewresearch.org/journalism/2022/10/06/prominent-accounts-on-alternative-social-media-sites-mostly-are-individuals-not-organizations/>